

KRITERET E PRANIMIT NË CIKLIN E DYTË PËR VITET AKADEMIKE 2021-2022

1. Master i Shkencave Inxhinieri Matematike dhe Informatike

- Nota mesatare sa më e lartë.
- Kandidati të ketë mbaruar Bachelor në Programin “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”, ose “Matematikë” në FSHN ose programe të ngjashme brenda ose jashtë vendit. Për kandidatët që nuk kanë mbaruar Bachelor IMI, mesatarja e notave duhet të jetë jo më e vogël se 7 dhe me koeficient 0.8.

2. Master Profesional Inxhinieri Matematike dhe Informatike

- Nota mesatare
- Kandidati të ketë mbaruar Bachelor në Programin “Inxhinieri Matematike dhe Informatike” ose programe të ngjashme brenda ose jashtë vendit. Për kandidatët që nuk kanë mbaruar Bachelor IMI, mesatarja e notave duhet të jetë jo më e vogël se 6.

3. Master i Shkencave në Informatikë

- Të ketë mbaruar Ciklin e Parë të Studimeve “ Bachelor në Informatikë” dhe “ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” si dhe programe studimi të njëvlefshme me to në vende të zhvilluara.

4. Master i Shkencave në Teknologji Informacioni

- Të ketë mbaruar Ciklin e Parë të Studimeve “ Bachelor në Informatikë” dhe “ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” si dhe programe studimi të njëvlefshme me to në vende të zhvilluara.

5. Master i Shkencave AML Informatikë

Të ketë mbaruar Ciklin e Parë të Studimeve “ Bachelor në Informatikë”.

6. Master Profesional në Teknologji Informacioni

- Të ketë mbaruar Ciklin e Parë të Studimeve “ Bachelor në Informatikë” dhe “ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” si dhe “Inxhinieri Matematike dhe Informatike”, “Matematikë”, “Fizikë” pranë fakultetit tonë, “Informatikë Ekonomike” pranë Fakultetit të Ekonomisë, Degët e “ Inxhinieri Informatikë” , “Inxhinieri Elektronike”, “ Inxhinieri Telekomunikacioni” pranë Universitetit Politeknik; studime të fushës së Ekonomisë dhe Shkenca Juridike pranë UT si dhe programe studimi të njëvlefshme me to.

7. Master Profesional në Informatikë Biznesi

- Të ketë mbaruar Ciklin e Parë të Studimeve “ Bachelor në Informatikë” dhe “ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” si dhe Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Matematikë pranë fakultetit tonë, “Informatikë Ekonomike” pranë Fakultetit të Ekonomisë, Degët e “ Inxhinieri Informatikë” , “Inxhinieri

Elektronike”, “ Inxhinieri Telekomunikacioni” pranë Universitetit Politeknik si dhe programe studimi të njëvlefshme me to.

8. Master i Shkencave në Fizikë

- Kandidatët duhet të jenë diplomuar në Ciklin e Parë të studimeve (“Bachelor”) në Universitetet e vendit ose të huaja në programet: Fizikë, Fizikë–Matematikë, Matematikë Inxhinierike, Fizikë Inxhinierike, Kimi, Biologji, Kimi Industriale dhe Mjedisore, Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Bioteknologji.

9. Master i Shkencave AML në Fizikë

- Kandidatët duhet të jenë diplomuar në Ciklin e Parë të studimeve (“Bachelor”) në Universitetet e vendit ose të huaja në programet : Fizikë, Fizikë–Matematikë, Matematikë Inxhinierike, Fizikë Inxhinierike, Kimi, Biologji, Kimi Industriale dhe Mjedisore, Kimi dhe Teknologji Ushqimore, Bioteknologji.

Shënim: Pranimet në programet 8 dhe 9 do të bëhen duke i renditur studentët sipas notës mesatare brenda kuotave të pranimit.

Si vlerë për mesataren e studentëve të degës “Fizikë”, FSHN do të merret mesatarja e tre viteve “Bachelor” shumëzuar me koeficientin 1.3, ndërkohë që për aplikantët e tjerë do të shumëzohet me koeficientin 1.

10. Master i Shkencave në Matematikë

- Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në një program studimi të ciklit të parë sipas listës së mëposhtme ose në një program studimi ekuivalent me të sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”

Përparësi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Universitetin e Tiranës.

Lista e programeve të studimit që mundësojnë pranimin në këtë program studimi të renditur sipas përparësisë, është si më poshtë:

- Programi i studimit “Bachelor në Matematikë” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (Universiteti i Tiranës).
- Programi i studimit “Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Informatike” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (Universiteti i Tiranës) me notë mesatare të përgjithshme mbi 5.5.
- Programi i studimit “Bachelor në Matematikë” në universitetet e tjera të vendit me notë mesatare të përgjithshme mbi 5.5.
- Programi i studimit “Bachelor në Matematikë” në universitete jashtë vendit, me diplomë të njësuar në Ministrinë e Arsimit e të Sporteve me mesatare të specialitetit mbi 5.5.

- Programi i studimit “Bachelor” me dy drejtime ku njëri është Matematikë, si “Matematikë-Fizikë”, “Matematikë-Informatikë”, etj në universitetet e tjera të vendit me mesatare të përgjithshme e atë të specialitetit mbi 6.

Vlerësimi i këtyre programeve studimi të ciklit të parë që lejojnë pranimin në këtë program studimi kryhet nga Departamenti i Matematikës, përgjegjës për këtë program.

Në rast të mos mbushjes së numrit minimal të studentëve për hapjen e programit të studimit “Master” të caktuar nga MASR, Departamenti mund të ulë notat minimale të paraqitura deri në mbushjen e atij numri.

11. Master i Shkencave AML Matematikë

Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në një program studimi të ciklit të parësipas listës së mëposhtme ose në një program studimi ekuivalent me të sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015 “për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”

Përparësi kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë në Universitetin e Tiranës.

Lista e programeve të studimit që mundësojnë pranimin në këtë program studimi të renditur sipas përparësisë, është si më poshtë:

- Programi i studimit “Bachelor në Matematikë” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës (Universiteti i Tiranës) me notë mesatare të përgjithshme mbi 5.2.
- Programi i studimit “Bachelor në Matematikë” në universitetet e tjera të vendit me notë mesatare të përgjithshme mbi 6.
- Programi i studimit “Bachelor në Matematikë” në universitete jashtë vendit me notë mesatare të përgjithshme mbi 6.
- Programi i studimit “Bachelor në Informatikë” në Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT apo në universitete jashtë vendit me notë mesatare të përgjithshme mbi 6.
- Programe studimi “Bachelor” me dy drejtime, ku njëri nga të cilët është matematikë si “Matematikë-Fizikë”, “Matematikë-Informatikë” etj në universitetet e tjera të vendit me mesatare të përgjithshme e atë të specialitetit mbi 6.

Vlerësimi i programeve të studimit të ciklit të parë që lejojnë pranimin në këtë program studimi kryhet nga Departamenti i Matematikës, përgjegjës për këtë program.

12. Master i Shkencave Bioteknologji Molekulare dhe Industriale

Pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

| | |
|---|-----------------------------------|
| Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë | |
| | 1. Dega Bioteknologji, FSHN, UT |
| | 2. Dega Biologji, FSHN, UT. |
| | 3. Dega Kimi Ushqimore, FSHN, UT. |
| Nga institucione të tjera të arsimit të lartë | |

| | |
|--|--|
| | <p>Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë. Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit, UBT. Programet: Agromjedis dhe Ekologji, Hortikulturë, Mbrojtje bimësh, Prodhim Bimor, Teknologji Agrorëshqimore, Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi. Programi Biologji-kimi, Universiteti “Fan Noli”, Korçë. Programet: Biologji-Kimi; Mjeksi e bimëve dhe Hortikulturë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”. Programi Biologji-Kimi, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Programi Biologji-Kimi. Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë. Programi Biologji. Programet Inxhinieri Mjedisit, Universiteti Politeknik.</p> |
|--|--|

Kritere të tjera pranimit:

| | |
|----|--|
| 1 | Të kenë Diploma të Nivelit të Parë në Degët e Përmendura në pikëna) dhe b). |
| 2. | Jo më vonë se 5 vjet pas diplomimit. |
| 3. | Nëse numri i kërkesave tejkalon numrin e kuotave të miratuara, përzgjedhja bëhet bazuar në notën mesatare. |

13. Master Profesional Bioteknologji Mjedisore

| | |
|----|---|
| 1. | Të zotërojnë BSc; ose MSc; ose Diplomë të integruar të nivelit të dytë; ose Diplomë sipas sistemit të vjetër. |
| 2. | Nëse numri i studentëve të interesuar është më i madh se ai i propozuar, do të nënshtrohen konkursit të pranimit. |
| 3. | Kriter seleksionues është nota mesatare e ciklit të parë të studimeve. |

Procedurat e pranimit të studentëve dhe të njohjes së krediteve universitare të fituara më parë prej tyre

pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program;

| | |
|---|--|
| Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë | |
| | <p>1. Bioteknologji, FSHN, UT 2. Biologji, FSHN, UT 3. Dega Kimi Industriale, FSHN, UT.</p> |
| Nga institucione të tjera të arsimit të lartë | |
| | <p>Fakulteti Bujqësisë dhe Mjedisit, UBT. Programet: Agromjedis dhe Ekologji, Hortikulturë, Mbrojtje bimësh, Prodhim Bimor, Teknologji Agrorëshqimore, Akuakulture dhe Menaxhim Peshkimi. Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, Programi Biologji-kimi. Universiteti “Fan Noli”, Korçë, Programet: Biologji-Kimi. Mjeksi e bimëve dhe Hortikulturë, Universiteti “Luigj Gurakuqi “. Programi Biologji-Kimi Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Programi Biologji-Kimi Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, UPTDrejtimi: Inxhinieri Mjedisit</p> |

14. Master i Shkencave në “Biologji Molekulare”

Shënim: Studentët të cilët kanë përfunduar “Bachelor në Biologji”, FSHN, UT, të kenë koeficientin e përlogaritjes **1**, ndërsa studentët të cilët kanë mbaruar “Bachelor në Bioteknologji”, FSHN, UT, vetëm për drejtimin AML, të kenë koeficientin **1**;

Të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet në programet e Universiteteve të tjera publike si dhe departamentin e Bioteknologjisë të përmendura si më poshtë, të kenë koeficientin **0.8**.

- Kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet në programet e studimit të ngjashme në “Universitetin e Shkodrës”, “Universitetin e Elbasanit”, “Universitetin e Gjirokastrës”, “Universitetin e Vlorës”, “Universitetin e Korçës”, “Universitetin e Durrësit”, “Universitetin Mjekësor”, “Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT” e të tjerë.

15. Master i Shkencave në Biologji Mjedisore

- Kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet në programet e studimit të ngjashme në Universitetin e Shkodrës”, “Universitetin e Elbasanit”, “Universitetin e Gjirokastrës”, “Universitetin e Vlorës”, “Universitetin e Korçës”, Universitetin Politeknik të Tiranës, “Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT” e të tjerë.

16. Mater i Shkencave AML Biologji

- Kandidatët duhet të kenë përfunduar studimet në programet e studimit të ngjashme në “Universitetin e Shkodrës”, “Universiteti e Elbasanit”, “Universitetin e Gjirokastrës”, “Universitetin e Vlorës”, “Universitetin e Korçës”, “Universitetin e Durrësit”, “Universitetin Mjekësor”, “Departamenti i Bioteknologjisë, FSHN, UT” e të tjerë.

17. Master i Shkencave në: Kimi industriale e mjedisore

Të ketë përfunduar:

- Bachelor në : Kimi Industriale e Mjedisore, FSHN, UT
- Bachelor në : Kimi e Teknologji Ushqimore, FSHN, UT
- Bachelor në : Kimi

18. Master i Shkencave në: Shkencat e teknologjitë ushqimore

Të ketë përfunduar:

- Bachelor në : Kimi e Teknologji Ushqimore, FSHN, UT
- Bachelor në : Kimi Industriale e Mjedisore, FSHN, UT
- Bachelor në : Kimi, FSHN, UT
- Farmaci, UMT
- Bachelor në: Teknologji agroushqimore, UBT

19. Master i Shkencave në: Inxhinieri e proceseve kimike

Të ketë përfunduar:

- Bachelor në : Kimi e Teknologji Ushqimore, FSHN, UT
- Bachelor në : Kimi Industriale e Mjedisore, FSHN, UT
- Bachelor në : Inxhinieri mekanike, UPT

- Bachelor në: Kimi Mjedisore, UPT

Shënim: Për çdo drejtim masteri me numër rendor 16, 17, 18, brenda kuotave kriteri renditës është nota mesatare.

20. Master i Shkencave Kimi

- Kandidati duhet të zotërojë diplomën Bachelor “Kimi”, Bachelor “Kimi Industriale dhe mjedisore”, Bachelor “Kimi Ushqimore”

Renditja e kandidatëve bëhet sipas mesatares se ponderuar duke patur parasysh kreditet e lëndëve shumëzuar me koeficientët 1 për Kimi dhe 0.9 për të tjerat.

21. Master i Shkencave AML Kimi

- Kandidati duhet të zotërojë diplomës Bachelor “Kimi”, “Kimi dhe Teknologji Ushqimore”, “Kimi Industriale dhe Mjedisore”, “Biologji”, “Bioteknologji”, “Biologji-Kimi”.

Renditja e kandidatëve bëhet sipas mesatares se ponderuar duke patur parasysh kreditet e lëndëve shumëzuar me koeficientët 1 për Kimi dhe 0.9 për të tjerat.